



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 30.11.2022

Prot.65 (gjashtëdhjetëpesë)

Protokoll nr. 65

I mbajtur sot më datë 30.11.2022, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.10.2022;
3. Miratimin i raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve, pranë këshillit bashkiak “Mbi heqjen e mandatit të këshilltarit z. “Aldi Gazmond Mullalli”, pas heqjes dorë nga mandati i këshilltarit”;
4. P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin tetor 2022”;
5. P-V “Për zgjedhjen e Kryetarit të fshatit Vloçisht, pas vakancës së krijuar në këtë fshat”;
6. P-V “Për miratimin e dokumentit të politikave dhe planit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Maliq për periudhën janar-dhjetor 2023”;
7. P-V “Për caktimin e sipërfaqes prej 82 m², pjesë e pasurisë nr.1/106, e llojit “shesh”, zona kadastrale 2573, Maliq, si zonë parikimi për automjetet e Komisarariatit të Policisë Maliq, sipërfaqja e paraqitur si “parcela 2” në planin e vendosjes bashkëlidhur këtij projekt-vendimi”;
8. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Valentina Pashollari; Rexhina Hëna; Dritan Çami; File Qyrani; Floreta Zaçe; Vasilika Trajko; Esmeralda Spaho; Aramndo Dautllari; Llambi Kotmilloshi; Erinda Xheferllari; Klement Zere; Kujtim Demollari; Jonilda Koçllari; Tefik Meçollari; Ildir Limllari 16 (gjashtëmbëdhjetë) këshilltarë.

Këshilltarë online në platformën ZOOM:

Fatjon Brahimllari; Kristina Malelli; Gentiana Drabo; Kristina Jonusllari; Enida Avdoli 5 (pesë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata:

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu; Zv/Kryetari i Bashkisë znj.Jonila Xhihalli; Përgjegjse e Sektorit të Shërbimit Social znj.Ermanda Petriti; Roneldi Spaho; Specialist;

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve! Të nderuar kolegë këshilltarë, pjesmarës, fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, me rend dite prej 8 pikash me rendin e ditës dhe materialet jeni njohur më parë. Mbledhjen nga ekzekutivi po e shoqëron



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

nën/kryetarje bashkisë znj.Joni. verifikojmë korumin e mbledhjes, janë 16 Këshilltarë në sallë dhe 5 të tjerë na ndjkein online, Miratojmë rendin e ditës?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 16 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 5 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 21 vota pro, Faleminderit! Më lejoni t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar? Janë 6 vendime gjithësej 1 me karketer normativ dhe 5 me karekter kolektiv ose individual.

1-Vendim nr.95, datë 28.10.2022

“Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.94 datë 24.12.2021 “Miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës së Bashkisë dhe strukturave të saj, për vitin 2022”;

(kolektiv)

1-Vendim nr.92, datë 28.10.2022

“Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shtator 2022”;

2-Vendim nr.93, datë 28.10.2022

“Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”;

3-Vendim nr.94, datë 28.10.2022

“Për miratimin e listës së përfituesve nga projekti “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet të varfra dhe pa favorizuar, për vitin 2022”;

4-Vendim nr.96, datë 28.10.2022

“Për miratimin e dhënies me qira të pasurisë të pafryshtshme nr.579/1, zona kadastrale 3803, sipërfaqe 91891 m², fshati Vloçisht, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq”;

5-Vendim nr.97, datë 28.10.2022

“Miratimin e komisionit për ndjekjen e procesit të votimit për zgjedhjen e Kryetarve të fshatrave, Vloçisht, Selcë-Velçan pas vakancës së krijuar në këto fshatra”

Ornildi Demollari: Këto ishin vendimet. Miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 16 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 5 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 21 vota pro protokollin, Faleminderit! Kalojmë te pika e 3 e rendit të ditës, Miratimin i raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve, pranë këshillit bashkiak “Mbi heqjen e mandatit të këshilltarit z. “Aldi Gazmond Mullalli”, pas heqjes dorë nga mandati i këshilltarit”; Ftoj përfaqësuesit e komisionit të lexojnë raportin, File ke fjalën.

File Qyrani: Në zbatim ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 49 “Mandati i këshilltarit”, pika 4 gërma “b”, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, gërma j dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq”, neni 21 “Mbarimi i mandatit të këshilltarit” anëtarit të këshillit, të z.Aldi Gazmond Mullalli, dhe bazuar në kërkesën e z.Aldi Gazmond



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mullalli me nr.5685 Prot., date 02.11.2022 me Lendë: Kërkesë për dorëheqje (bashkangjitur raportit) i propozojmë këshillit bashkiak ,

- 1- Miratimin e raportit për heqjen e mandatit të z. Aldi Gazmond Mullalli kandidat në listen shumë-mërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, përgatitur nga Komisioni i Mandateve.
- 2- Sekretari i Këshillit të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore.

Komisioni i Mandateve:

Kryetar: Pranvera BEGOLLI

Anëtar: Fatjon BRAHIMLLARI

Anëtar: File QYRANI

Ornildi Demollari:Falemindert! E kalojmë votim raportin?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 16 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 5 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 21 vota pro, Faleminderit! Gjej rastin ta falenderoj kolegun tonë Aladin për gjithë angazhimin e tij dhe i urojmë suksese në angazhimet e tjera.Mbledhjen në sallë po e ndjekin disa nxënës, Këshilli Rinor.I Falendrojmë, një përfaqësues i Këshillit Rinor kërkon të thotë diçka.

Përfaqësues i Këshillit Rinor:Përshëndetje të gjithëve ju falenderoj në emër të Këshillit Rinor, që bëtë të mundur prezencën tonë në mbledhjen e Këshillit, kjo është një incitivë kombëtare, ku çdo Këshill Rinor duhet të jetë prezent në 15 mbledhje Këshilli.

Ornildi Demollari:Falemindert!Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin tetor 2022”;Ka ndonjë pyetje ose koment? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 16 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 5 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 21 vota pro, Faleminderit!Kalojmë te pika e 5 e rendit të ditës, P-V “Për zgjedhjen e Kryetarit të fshatit Vloçisht, pas vakancës së krijuar në këtë fshat”;

Ornildi Demollari:File mund të na thuash diçka lidhur me porcesin e zgjedhjes.

File Qyrani:Po procesi u zhvillua normalisht, votimi u bë i fshehtë nga anëtarët e kryesisë dhe në fund të procesit Kryetar i fshatit Vloçisht u zgjodh z.Bardhyl Çami.

Ornildi Demollari:Falemindert! E kalojmë votim P-V?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Zv/Kryetari i Bashkisë znj.Jonila Xhihalli:Jo biznesi nuk paguan taksë për pjesën e parkimit.Kemi një Instuacion që kërkon parkim, ta lemë pa parkim dhe tja japim Lokalit?
Roneldi Spaho; Specialist:Biznesi nuk ka bërë kërkesë për parikim më parë.

File Qyrani:Policia e ka larg parkimin që kërkon, pse bën kërkesn?

Zv/Kryetari i Bashkisë znj.Jonila Xhihalli:Është afër me Institucion parkimi që kërkohet!Është pjesa më e mirë për praktikim për Komisariatin.

File Qyrani:Të bëhet parkim me pagesë, vjelim dhe të ardhura për Bashkinë.

Ornildi Demollari:Ka ndonjë komnet tjetër? E kalojmë në votim? Kush është dakort? Nuk miratohet.Faleminderit!

Idlir Limllari:Ta përcaktojnë çfarë është ai vendi atje, dhe e miratojmë.

Ornildi Demollari: Dakort? Roneldi si përfaqësues i zyrës në mbledhjen e radhës P-V të sillet më i detajuar, mundësisht dhe me foto, dy përfaqësues nga Këshilli dhe Urbansitika të shkojnë ta shohin në vend se ku është kjo sipërfaqe dhe në mbledhjen e radhës marrim një vendim.Persim një moment se kërkon Kryetari i Bashkisë ti bashkohet mbledhjes.Kryetar jemi te P-V nr. Për caktimin e sipërfaqes prej 82 m², pjesë e pasurisë nr.1/106, e llojit “shesh”, zona kadastrale 2573, Maliq, si zonë parikimi për automjetet e Komisarariatit të Policisë Maliq”, në materialet nuk kishim bashkangjitur plan-vendosjen dhe Këshilltarët kanë disa paqartësi si për çfarë bëhet fjalë.

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:Përsëritet të gjithëve!Ne në fakt ashtu si ju e dini kemi bërë një ndërhyrje për të patur Komisariat Bashkia, që nuk e ka patur më parë dhe me ndihmën e donatorve dhe nga vetë Bashkia sot kemi një Komisariat dhe që ky Komisariat noramlisht ka nevojë dhe për parkim.Kemi ndërhyrë dhe para Komisaritati dhe kemi siguruar një trotuar në gjithë gjatësinë që sot është parikim, por këtë parikim po ta lemë të lirë do zihet nga qytetarë që lenë makinat.Prandaj dhe ne ju kërkojmë këtë, atje kemi dy zona një me pronar që nuk e kemi prekur dhe pjesa që i takon Institucionit që po ja japim Komisaritatit, nuk e kuptoj cili është shqetësimi këtu, për një shërbim që po i japim Policisë së shtetit.

Idlir Limllari:Në P-V nuk tregohet çfarështë Trualli, lulishte apo trotuar?

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:Bashkia e ka bërë aprikim e ka sistemuar si parikim duhet tja u kishin vendosur palnimetrinë, unë e kam firmosur atë, duhet tja u kshin bashkngjitur, ndoshta jo në atë format të madh, që këshilli të njiheshe ,Këshilltarët kanë shumë të drejtë dhe i kërkoj ndjesë, e kam kthyer disa herë, për mos prekur pronën private dhe rrugën e qytetarve.

File Qyrani:Unë e di qëatje aktualisht atje është parking, Policia e ka më alrg nga lokali dhe për Policinë nuk është vend i përshtatshëm atje.

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:Ne i japim një mundësi Policisë të ketë 4 vende të rrezervuara, do vemë dhe një tabelë me targa për mjetet e Policisë.Nuk mund ta lemë të parkohet çdo lloj mjeti.

File Qyrani:Bashkia ta bëjë parking me pagesë, ndonjë vend tjetër nuk ka?

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:Seshin para zjarrëfiksës ne duam ta zhvillojmë, jo ta bëjmë zonë parkimi, do bëjmë Muze atje, shumë shpjegim do ju sjellim propozimin.

Ornildi Demollari: Dakort? E marrim dhe njëherë në votim? Pas shpejegimit që na dha Kryetari?





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:Një të drejtë mund të kenë Këshilltarët të lemë vende të rezervura për biznesin, kundrejt pagesës por ato nuk e kanë kërkuar.

Ornildi Demollari:Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra? File Qyrani; Idir Limllari

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 14 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 5 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 19 vota pro, Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu:Në mbledhjen e radhës do kërkoj një P-V, kush nuk vjen në mbledhje mos ketë pagesë, nuk mund të ketë kaq mungesa në mbledhje.

Ornildi Demollari:Konstatimi është me vend dhe besoj se në mbledhjet ardhshme do ketë reflektim.

Ornildi Demollari:Faleminderit! Kjo ishte mbledhja për sot.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

